



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

Tiranë, më 18.9.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN
(KFW), PËR PROGRAMIN E REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS SIPAS PARIMIT TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË,
FAZA II”**

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 shtator 2018, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efijencës së energjisë, faza II”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit përgjegjës dhe sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë sqarimet përkatëse, Zëvendësministri i Financave dhe përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

II. Përmbajtja e projektligjit.

Marrëveshja e financimit është nënshkruar nga palët më 13.12.2017, në vijim të marrëveshjes midis qeverive të të dy vendeve për bashkëpunimin financiar, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës, sipas parimit të efijencës energjitike, faza II”, e cila është ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.94/2017.

Marrëveshja parashikon marrjen, nga KfW, të një granti prej rreth 2 milionë eurosh, i cili do të përdoret për rehabilitimin e 5 godinave të konvikteve të Universitetit të Tiranës, për të përmirësuar

kushtet e jetesës së studentëve, duke zbatuar kërkesat për rritjen e efijencës së energjisë, të përcaktuara në:

- Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Energjitik, e cila parashikon rritjen e sigurisë në furnizimin me energji dhe optimizimin e burimeve të saj, me qëllim plotësimin e nevojave dhe zhvillimin e qëndrueshëm në të ardhmen;
- Ligjin nr.116/2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, i cili përcakton kërkesat kryesore lidhur me efijencën e energjisë në ndërtesat që i nënshtrohen rinovimit.

Programi parashikon studimin e performancës aktuale energjitike të ndërtesave, identifikimin e nevojave për rinovimin e sistemit të energjisë dhe të masave përkatëse, duke synuar reduktimin e konsumit, uljen e kostos dhe rritjen e efijencës së energjisë, si dhe përmirësimin e kushteve të studentëve. Ky program do të zbatohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia e Tiranës dhe Shoqëria Studentore Universitare e Qytetit të Tiranës, e cila është përfituese e projektit.

Kostoja e plotë e projektit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës, sipas parimit të efijencës së energjisë, është 7.8 milionë euro dhe do të financohet nga:

- 2 milionë euro granti i KFW sipas këtij projektligji (faza II);
- 4.5 milionë euro nga marrëveshja e financimit e ratifikuar me ligjin nr.94/2014 (faza I);
- buxheti i shtetit, i cili do të mbulojë pagesën e TVSH-së dhe kostot lokale të projektit, me vlerë 1.3 milionë euro.

III. Vlerësimi i Komisionit.

Komisioni vlerëson se marrëveshja është mjaft e rëndësishme, pasi siguron financimin shtesë për rehabilitimin e sistemit energjitik të konvikteve të Universitetit të Tiranës, duke sjellë përmirësimin e kushteve të studentëve. Ky financim është në formën e grantit dhe do të rrisë efijencën e energjisë në konviktet e UT.

Komisioni është i mendimit se parimi i efijencës së energjisë duhet të shërbejë si kriter bazë për të gjitha ndërtesat publike. Strukturat kompetente duhet të kryejnë studimin e gjëndjes në të gjitha godinat e konvikteve të Universitetit të Tiranës, për të mundësuar rehabilitimin e sistemit energjitik të tyre sipas këtij parimi. Rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve, me qëllim që detyrimet kontraktore të zbatohen në afat e me cilësi.

IV. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORJA
Blerina GJYLAMETI

KRYETARI
Erion BRAÇE